

por motra e Ilmiut, e ndihmuar nga një njeri nga Juniku/Junik, e ka gjetur trupin e të vëllait më 23.08.1998 dhe, një ditë më vonë, e ka varrosur në varrezat e Kotradiqit/Kotradić. Pas përfundimit të luftës, më 24.08.1999, mbetjet mortore të Ilmiut janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Glllogjan/Glodane. Trupi i Visarit u gjet në muajin dhjetor të vitit 2001. Pas identifikimit, ai iu dorëzua familjes. U varros në fshatin Zakut [Podujevë/Podujevo]. Trupat e të tjerëve i kanë marrë pjesëtarë të UJ-së dhe i kanë varrosur në varrezat në Gjakovë/Đakovica.

Pas përfundimit të luftës, në muajin shtator të vitit 1999, u zhvarrosën mbetjet mortore të Artonit, Nimonit, Agronit dhe Nazmiut. Artoni dhe Nazmiu u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Orrobërdë/Orno Brdo; Agroni u rivarros në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Negroc/Negrovcë më 18.09.1999, ndërkaq Nimoni në varrezat në Vrellë/Vrelo më 20.09.1999; në datën 12.08.2000, familjarët i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Abdullahut dhe i kanë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Prishtinë/Priština; familjarët e Bekimit janë njoftuar më 25.08.2003, se mbetjet e tij mortore ishin zbuluar në varrezat e Pejës/Peć. Një ditë më vonë, Bekimi u varros në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabnica [Klinë/Klina].

Kufomat e Bashkimit, Ademit dhe Shefqetit nuk janë gjetur deri më sot. Në muajin qershor të vitit 1999, në malët e *Gjeravicës/Đeravica*, në afërsi të Junikut/Junik, babai i Ademit, Ramadani, i ka gjetur këpucën dhe kostumin e udhës së të birit, në të cilin gjendej një kockë njeriu. Zhdukja e Bashkimit është evidentuar nga KNKK-ja në lëndën me numrin rendor BLG-804808-01 [në vitin 2008, KNKK-ja e ka hequr nga evidenca e vet rastin e zhdukjes së Shefqetit, por familjarët ende nuk i kanë gjetur mbetjet e tij mortore]. Zhdukja e Ademit as që është paraqitur te KNKK-ja.

Burimet: deklarata R.A, FDH-29792; deklarata T.K, FDH-31833; deklarata N.S, FDH-11407; deklarata R.K, FDH-29574; deklarata H.A, FDH-18753; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Abaz (Bajrush) Hoti

(1.04.1945, shqiptar nga fshati Piskotë/Piskot, opština Đakovica/Gjakovë, vozitës, shtatë fëmijë)

Abazi punonte në fabrikën *Metaliku* të Gjakovës/Đakovica. Me familjen e vet jetonte në fshatin **Piskotë/Piskot**. Nga droja prej sulmeve të policisë serbe, që nga fillimi i korrikut të vitit 1998, Abazi dhe familjarët e tij shkonin çdo mbrëmje në Gjakovë/Đakovica, ku natën e kalonin te familja e Ahmet Koles. Në shtëpi u kthenin në mëngjes. Në datën **18.07.1998**, nga ora 16:00, Abazi e kishte çuar lopën në kullotë në një fushë, afro 600 metra larg shtëpisë dhe në afërsi të fabrikës *Ereniku*. Dy orë më vonë, familjarët kanë dëgjuar një të shtënë nga ai drejtim. Bashkëshortja e Abazit, Rukija, dhe djali Bajrush i nisën për të parë çfarë ka ndodhur, por një fqinje e tyre, malazeze, i ka kthyer mbrapa duke u thënë se Abazin e kishin vrrarë dhe se ishte shumë e rrezikshme për të shkuar në vendin e ngjarjes. Gjatë së njëjtës ditë, policia e ka marr trupin e Abazit dhe e ka çuar në morgun e Gjakovës/Đakovica. Një ditë më vonë, Bajrushit dhe të afërmeve të tij policia u ka komunikuar se Abazi i kishte sulmuar policët dhe se ata u detyruan ta vrisnin. Por, nga fqinja e tyre malazeze, familjarët e Abazit kanë mësuar se atë e ka vrrarë një banor i fshatit [identiteti i tij është i njohur për FDH]. Familjarët e kanë marrë trupin e Abazit nga morgu i Gjakovës/Đakovica më 19.07.1998 dhe e kanë varrosur në varrezat lokale.

Burimet: deklarata B.H, FDH-30771; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, III, 119; SMIP, *Teroristički...*, III, 911; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817.

Palë (Dedë) Krasniqi

(14.04.1976, shqiptar nga Peja/Peć)

Palë Krasniqi me familje jetonin në lagjen *Dardania/Brežanik* në Pejë/Peć. Ishte i papunë. Një ditë të pacaktuar të muajit korrik të vitit 1998, ai me mikun Mahir Demajn kanë shkuar në **Jabllanicë/Jablanica** për tu inkuadruar në UÇK. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e shihnin atë